



Drejtoria për Arsimit

Nr. 11-19716 /2024

Klinë 21.06 /2024

Kërkesë për fillimin e Rekrutimit- Punësimit KONKURS PUBLIK

Në mbështetje të nenit 80 dhe 81 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në mbështetje të dispozitave të Udhëzimit Administrative (MFPT) Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 35 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-32, nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 05/2015 për mësimdhënësit e arsimit profesional, UA 05/2021 Normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm

PËR: Kryetarin e Komunës dhe Shefin i Personelit

NGA: Dr.sc. Qemajl Sejdiq – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Titulli i vendit të punës që propozohet:

- 1 Mësimdhënës për Lëndën e Gjuhës Frënge në Gjimnazin “Luigj Gurakuqi” në Klinë 15 orë, pozitë e lirë.

Klasa/Koeficienti E17/5.8 për mësimdhënës në shkolla të mesme të larta.

Kualifikimi:

UA 05/2021 Normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Sqarim: Duke u bazuar në **UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MASHT) Nr. 12-2018 PARIMET DHE PROCEDURAT E NJOHJES SE DIPLOMAVE GRADAVE DHE KUALIFIKIMEVE TË SHKOLLAVE TË LARTA PROFESIONALE DHE UNIVERSITARE TË FITUARA JASHTË REPUBLIKËS SË KOSOVËS:** Të gjithë kandidatet që studimet universitare i kanë të përfunduar jashtë Republikës së Kosovës diplomat e tyre duhen të jenë të nostrifikuara në qendrën NARIC/MASHT dhe me rastin e aplikimit në konkurs se bashku me dokumentet (Diplomat) duhen ti bashkëngjisnin edhe vendimin e nostrifikimit për diplomat përkatëse në të kundërtën gjatë verifikimit paraprak të dosjeve Njësia e Burimeve Njerëzore do të i anuloi aplikimet e këtyre kandidateve si aplikime të pa kompletuara.

Lloji i pozitës : i karrierës

Me orar të plotë- PO

A është e përfshirë pozita në planin e personelit -PO

A ka masë buxhetore- PO

Cila është arsyeja për rekrutim, ekziston vendi i zbrazet, ka mjete buxhetore, ka PCF të miratuar.

Përshkrimi i detyrave punuese:

-Të realizojë planin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore;

-Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me kurrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;

-Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;

-Të kontrollojë me rregull dhe të mbajë evidencën për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënësi, si dhe të jetë në gjendje të raportojë prindit apo kujdestarit të familjes;

-Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe aktiviteteve të tjera në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës;

-Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual ;

-I punësuar është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore;

-Bashkëpunon me organet e shkollës dhe me të gjitha institucionet tjera profesionale.

VLERSIMI I UDHEHEQESIT ME TË LARTË

A pranohet kërkesa për rekrutim PO ose JO

Nëse refuzohet arsyetimi _____

Nënshkrimi i udhëheqësit me të lartë _____

